



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1695/1 Prot

Tiranë, më 05.12.2019

V E N D I M

Nr.155, datë 05.12.2019

“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Memaliaj, të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil, në këtë bashki”.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e kryer në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Memaliaj,

VËREJ SE,

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit, me Urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, “Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje

me parimet e ligjit për nëpunësin civil”, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore (61 bashkitë e vendit), ku përfshihet edhe Bashkia Memaliaj.

Nga aktet e administruara gjatë inspektimit në subjekt, ka rezultuar se Bashkia Memaliaj, është e organizuar dhe funksionon në bazë të strukturës dhe organikës të miratuar me Urdhër nr. 73, datë 26.12.2018, të Kryetarit të Bashkisë Memaliaj, e cila është në fuqi edhe në momentin e kryerjes së verifikimit.

Sipas strukturës aktuale, Bashkia Memaliaj, në përbërje të saj, ka gjithsej **31** pozicione pune të vlerësuara si pjesë e shërbimit civil, të cilat sipas kategorive klasifikohen: **1** pozicion i kategorisë së lartë drejtuese, **1** pozicion i kategorisë së mesme drejtuese, **8** pozicione të kategorisë së ulët drejtuese, **21** pozicione të nivelit ekzekutive.

Gjatë procesit të verifikimit në subjekt u konstatua se, **24** pozicione pune të shërbimit civil, janë plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, **2** pozicione të shërbimit civil, rezultojnë së aktualisht janë plotësuar me punonjës të emëruar me akt të përkohshëm emërimi apo kontrata të përkohshme, dhe jo sipas një procedure konkurrimi të hapur, ndërsa **5** pozicione rezultuan të lira.

Konkretisht, rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin evidentohen si më poshtë, ku specifikohet pozicioni i punës dhe punonjësi që kryen aktualisht detyrën, si edhe akti i emërimit i nxjerrë nga titullari i institucionit:

- 1- ***** , emëruar me vendimin nr. 73, datë 09.07.2019, të Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin e punës Specialiste e Burimeve Njerëzore dhe Apelit Tatimor.
- 2- ***** , emëruar me vendimin nr. 32, datë 01.02.2019, të Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin e punës, Përgjegjës i Sektorit Bujqësor, Veterinar dhe Mjedisit.

Komisioneri konstaton se, aktet e mësipërme të emërimit, kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi në bazë të neneve 22 – 26, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, pranimet në shërbimin civil duhen bërë, duke respektuar detyrimisht një procedurë të rregullt konkurrimi. Çdo akt administrativ i nxjerrë në kundërshtim me këtë rregull, në vështrim të nenit 108, pikat i) dhe ii) të shkronjës “a” dhe shkronjës “ç”, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, është absolutisht i pavlefshëm. Për më tepër, ndalimi i emërimit në kundërshtim me procedurën, për pozicionet e nivelit

ekzekutiv, është theksuar shprehimisht edhe në pikën 4, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Në vijim të këtij arsytimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë.

Nisur nga detyrimi i parashikuar nga neni 111, i ligjit në fjalë, organi publik, në këtë rast Kryetari i Bashkisë Memaliaj, duhet të evidentojë në këto veprime administrative, ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit si më lart dhe të konstatojë pavlefshmërinë absolute të këtyre akteve, shoqëruar kjo me përcaktimin e masave për rregullimin e pasojave duke ndërprerë marrëdhënien e punës të lidhur në kundërshtim me procedurat ligjore dhe më tej, shpalljen e këtyre pozicione vakante për t’u plotësuar në përputhje me ligjin për nëpunësin civil.

Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, duhet të kujdeset të përmbushë rregullat e përcaktuara në kreun IV “Pranimi në shërbim civil”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.

Është konstatuar gjithashtu se, për **11** pozicione për të cilat ka përfunduar procesi i konkurimit, periudha e provës dhe trajnimi i detyrueshëm në ASPA, punonjësit janë në pritje të konfirmimit ose jo të statusit të punësimit. Bëhet fjalë për punonjësit si më poshtë:

1. ***** emëruar me Vendimin nr. 62, datë 04.09.2017 “Për emërim në periudhë provë”, në pozicionin e punës specialist i IT-së.
2. ***** emëruar me Vendimin nr. 23, datë 02.05.2018 “Për emërim në detyrë në periudhë provë”, në pozicionin e punës Specialist Mjedisi .
3. ***** emëruar me Vendimin nr. 24, datë 02.05.2018 “Për emërim në periudhë prove” në pozicionin e punës Specialist Buxheti.
4. ***** emëruar me Vendimin nr. 39, datë 26.06.2018 “Për emërim në periudhë prove” në pozicionin e punës Specialist i Urbanistikës.
5. ***** emëruar me Vendimin nr. 95, datë 09.11.2018 “Për emërim në periudhë prove” në pozicionin e punës Specialist i Shfrytëzimit të Pyjeve.

6. ***** emëruar me Vendimin nr. 96, datë 09.11.2018 “Për emërim në periudhë prove” në pozicionin e punës Specialist Arsimi.
7. ***** emëruar me Vendimin nr. 94, datë 09.11.2018 “Për emërim në periudhë prove” në pozicionin e punës Specialist Shërbimesh.
8. ***** emëruar me Vendimin nr. 100, datë 09.11.2018 “Për emërim në periudhë prove” në pozicionin e punës Specialist i Taksa- Tatimeve.
9. ***** emëruar me Vendimin nr. 110, datë 03.12.2018 “Për emërim në periudhë prove” në pozicionin e punës Specialist i Emergjencave Civile.
10. ***** emëruar me Vendimin nr. 98, datë 09.11.2018 “Për emërim në periudhë prove” në pozicionin e punës Specialist Kulture.
11. ***** emëruar me Vendimin nr. 99, datë 09.11.2018 “Për emërim në periudhë prove” në pozicionin e punës Specialist i Ndihmës Ekonomike në Njësinë Administrative Buz.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, nga ana e institucionit, është vepruar në përputhje me ligjin në lidhje me procesin e konkurrimit por duhet të vijojë finalizimi i procesit të konfirmimit si nëpunësa civilë, për personat që ka përfunduar periudha e provës.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Memaliaj, të konstatojë si akte administrative absolutisht të pavlefshëm, 2 rastet e emërimit të punonjësve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, që janë:
 - ***** , emëruar me vendimin nr. 73, datë 09.07.2019, të Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin e punës Specialiste e Burimeve Njerëzore dhe Apelitimit Tatimor.

- *****, emëruar me vendimin nr. 32, datë 01.02.2019, të Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin e punës, Përgjegjës i Sektorit Bujqësor, Veterinar dhe Mjedisit.

dhe të rregullohen pasojat duke i shpallur këto pozicione të lira, për t'u plotësuar në përputhje me ligjin.

2. Të finalizohet procesi i konfirmimit nga ana e eprorit direkt dhe Njesisë Përgjegjëse për **11** rastet e nëpunësve që kanë përfunduar periudhën e provës dhe kanë kryer trajnimin e detyrueshëm pranë ASPA-s, të cilat janë evidentuar më sipër, në pjesën arsyetuese të vendimit.

Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Memaliaj, të njoftojë të gjithë personat e evidentuar në këtë vendim, për të cilët nuk është konfirmuar statusi i nëpunësit civil si dhe eprorët e drejtpërdrejt të tyre për të realizuar detyrat që kanë lidhje me procesin e konfirmimit të statusit të punësimit për punonjësit që kanë përfunduar periudhën e provës.

3. Të përgatitet dhe të miratohet plani i nevojave për rekrutimin në shërbimin civil për vitin e ardhshëm, për të gjitha pozicionet e mbetura vakant deri në shkurt të vitit 2020, duke respektuar procedurat dhe afatet e përcaktuara në vendimin nr. 108, datë 26.2.2014 të Këshillit të Ministrave, "*Për planin vjetor të pranimi në shërbimin civil*".
4. Të përmbillet procesi i mbikëqyrjes i cili është materializuar me vendimin paralajmërues nr. 24, datë 13.04.2018, të Komisionerit dhe të vijojë rregullimi i situatës ligjore në këtë subjekt sipas dispozitivit të këtij vendimi paralajmërues për këtë insitucion.
5. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **2 (dy) muaj** nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i inspektuar dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në pjesën arsyetuese të tij. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore Bashkia Memaliaj, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
6. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjositjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

7. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Memaliaj, Ministria e Brendshme dhe Prefekti i Qarkut Gjirokastrë. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Memaliaj të njoftojë çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin dhe që është i evidentuar në këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha